

Vizita historike e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, Javier Pérez de Cuéllar në Shqipëri (11–13 maj 1990): Një pikë kthese në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rrjedhat politike shqiptare

Konteksti politik dhe diplomatik i vizitës

Në fillim të viteve 1990, Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë që ende nuk kishte nisur procesin e tranzicionit politik nga komunizmi në demokraci. Regjimi i Ramiz Alisë përpiqej të ruante balancën midis presioneve të brendshme të jashtme për ndryshim dhe dëshirës për të mbajtur nën kontroll strukturat shtetërore e ideologjike. Në këtë atmosferë të tensionuar, vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Javier Pérez de Cuéllar, më 11–13 maj 1990, përfaqësoi një moment kyç për pozicionimin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe për nxitjen e një hapjeje të vonuar ndaj Perëndimit.

Ftesa zyrtare për këtë vizitë ishte bërë nga Ministri i Jashtëm shqiptar Reis Malile gjatë Asamblesë së 44-të të Përgjithshme të OKB-së, në tetor të vitit 1989, në përpjekje për të përmirësuar imazhin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe për të sinjalizuar një vullnet të kufizuar për reformë. Sekretarit i Përgjithshëm De Kuellar e pranoi ftesën dhe vizita u planifikua të zhvillohej në 11-13 maj 1990. Ky ishte një zhvillim i rëndësishëm për politikën e jashtme të Shqipërisë së asaj kohe që e shikonte me rezerva OKB-në dhe misionin e saj për shkak të peshës që kishin atje SHBA e BRSS, me të cilat Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike. Aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë reagueshan që kjo vizitë të mos zhvillohej me argumentin se në Shqipëri shkeleshin të drejtat e njeriut. Në mars 1990 Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Gjenevë miratoi një Rezolutë mbi të drejtat e njeriut në Shqipëri. Në këtë Rezolutë rekomandohej që gjetjet e saj të mbaheshin parasysh gjatë vizitës së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB në Tiranë. Vizita ishte pjesë e një turneu më të gjerë të Pérez de Cuéllar në Evropën Lindore, që përfshinte Hungarinë dhe Çekosllovakinë, vende që tashmë kishin hyrë në një proces demokratizimi.

Axhenda e vizitës dhe takimet zyrtare

Vizita zgjati tre ditë dhe përfshiu takime me Presidentin e Republikës Ramiz Alia, Kryeministrin Adil Çarçani dhe Ministrin e Jashtëm Reis Malile. Në këto takime, de Kuellar përçoi një mesazh të qartë: Shqipëria duhet të hapet politikisht dhe ekonomikisht, të orientohet nga Perëndimi dhe të shmangë skenarin e dhunshëm të ngjashëm me atë që ndodhi në Rumani. Ai kërkoi konkretisht përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut, liberalizimin e lëvizjes së qytetarëve, tolerancën fetare, lirimin e pronës private dhe lejimin e një pluralizmi politik.

De Kuellar u vu ne dijeni se Shqipëria kishte vendosur të bashkohej me proceset e sigurimit dhe bashkëpunimit evropian. Ai përshëndeti hapjen e Shqipërisë në politikën e jashtme, bashkëpunimin në mënyrë aktive me shtetet e tjera të

Ballkanit dhe propozoi hapjen e një zyre të PNUD në Shqipëri, aderimin në konventën e të drejtave të njeriut, përfaqësimin e Shqipërisë me punonjësit e saj në Sekretariatit e OKB, si dhe premtoi që të nxiste bashkëpunimin e Komisionit Ekonomik për Evropën për t'i dhënë Shqipërisë ndihmë ekonomike në përpjekjet e saj për të kryer reforma.

Nga ana tjetër, pala shqiptare u përpoq të paraqiste Shqipërinë si një vend të pavarur, të vogël por të ndershëm, që nuk bënte pjesë në asnjë bllok ushtarak apo politik dhe që dëshironte rritjen e rolit të OKB-së si organizatë mbi palët. Ramiz Alia mbajti një qëndrim mbrojtës, duke theksuar “idealizmin socialist shqiptar” dhe rëndësinë e sovranitetit kombëtar, duke iu shmangur detyrimeve konkrete për reforma.

Ndikimi i vizitës

Gjatë kësaj vizite De Kuelar adresoi edhe disa raste të shkeljeve të drejtave të njeriut në Shqipëri të evidentuara në rezolutën e Komisionit të të Drejtave të Njeriut, duke kërkuar një qëndrim të drejtë në përputhje me Deklaratën e OKB për të Drejtat e Njeriut. Megjithë refuzimin fillestar të elitës komuniste për të ndërmarrë hapa të menjëhershëm politikë, vizita e Pérez de Cuéllar kishte disa efekte të drejtpërdrejta e të prekshme:

- Në vijim të rekomandimeve të Rezolutës mbi të drejtat e njeriut në Shqipëri, mars 1990, të Komisionit të të Drejtave të Njeriut në Gjenevë Sekretari I Përgjithshëm de Cuelar adresoi incidentin e vëllezërve Popaj, që qëndronin të strehuar në ambasadën italiane që prej vitit 1985, u bë e mundur menjëherë pas largimit të Sekretarit të Përgjithshëm. Popajt u pajisën me pasaporta shqiptare dhe u lejuan të largoheshin drejt Italisë, një sinjal i qartë për një fleksibilitet të ri të qeverisë shqiptare.
- Ndikimi psikologjik dhe moral te qytetarët shqiptarë ishte i madh: kjo ishte vizita e parë e një figure kaq të rëndësishme ndërkombëtare në Shqipëri dhe krijoi një ndjesi të pathyeshmërisë së ndryshimeve që po afroheshin.
- Shpërthimi i ngjarjeve të 2 korrikut 1990, kur mijëra shqiptarë hynë në ambasadat e huaja në Tiranë për të kërkuar azil politik, lidhet drejtpërdrejt me efektin e kësaj vizite. Vizita kishte rritur ndërgjegjësimin dhe guximin e qytetarëve për të sfiduar kufizimet e regjimit.

Roli i OKB-së pas vizitës: ndërmjetësimi dhe parandalimi i krizës

Pas shpërthimit të krizës së ambasadave më 2 korrik 1990, kur rreth 5,000 qytetarë shqiptarë u futën në ambasadat e huaja në Tiranë, OKB u aktivizua si një aktor kyç. Me kërkesën e Komunitetit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm de Kuéllar ndërhyri menjëherë me një letër zyrtare drejtuar Ministrit Malile më 5

korrik, duke kërkuar respektimin e të drejtës për lëvizje dhe lejimin e largimit të qytetarëve.

OKB-ja dërgoi në Tiranë përfaqësuesin e posaçëm, diplomatin suedez Staffan De Mistura, i cili gjatë bisedimeve maratonë më 9–11 korrik arriti një kompromis që shmangu përplasjen midis qeverisë shqiptare dhe ambasadave të huaja. Kjo ndërhyrje jo vetëm që parandaloi një katastrofë humanitare, por edhe mbajti hapur mundësinë e Shqipërisë për të vazhduar procesin e anëtarësimit në KSBE dhe integrimin në organizatat evropiane.

Rëndësia historike e vizitës së Pérez de Cuéllar

Tridhjetë e pesë vite pas kësaj vizite historike, vizita e Javier Pérez de Cuéllar mbetet një nga episodet më domethënëse të përfshirjes ndërkombëtare në momentin e parë të tranzicionit shqiptar. Javier Pérez de Cuéllar u bë zëri i parë zyrtar ndërkombëtar që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, i kërkoj udhëheqjes komuniste shqiptare hapje të plotë nga vëhtëizolimi dhe reforma. Vizita e tij jo vetëm që shërbeu si katalizator për një ndryshim politik që do të ndodhte vetëm pak muaj më vonë, por gjithashtu rivendosi Shqipërinë si një subjekt aktiv në arenën ndërkombëtare.

Për më tepër, kjo vizitë shënoi edhe fillimin e një epoke të re të marrëdhënieve Shqipëri–OKB, ku Shqipëria jo vetëm do të përfitonte nga ndihma teknike e organizatave si PNUD, por do të ri-pozicionohej gradualisht në skenën diplomatike botërore si një vend në tranzicion demokratik.

Vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Javier Pérez de Cuéllar në Shqipëri më 11–13 maj 1990 ishte shumë më tepër sesa një vizitë zyrtare: ajo ishte një akt historik i ndërhyrjes diplomatike në një moment kyç për të ardhmen politike të vendit. Kjo vizitë shërbeu si një dritare për bashkëpunim ndërkombëtar, një alarm për rrezikun e izolimit të mëtejshëm dhe një shpresë për qytetarët që kërkonin liri, dinjitet dhe të ardhme.